

Raport i Grupit Ndërkombëtar të Punës mbi Edukimin Digjital shtator 2017



Konferenca e 39-të Ndërkombëtare e Komisionerëve të Mbrojtjes së të Dhënave dhe Privatësisë në Hong Kong

Isabelle FALQUE-PIERROTIN

Kryetar i Komisioni Kombëtar për Liritë dhe Informimin (CNIL), Moderator i Grupit Ndërkombëtar të Punës për Edukimin Digjital

Hyrje:

Si moderator i këtij grupi, do doja të falënderoja Zyrën e Komisionerit të Privatësisë të Zelandës së Re për punën e mirë të bërë nga stafi i Sekretariatit ICDPPC dhe për mbështetjen që ai i solli vizibilitetit të Grupit tonë të Punës për Edukimin Digjital, në veçanti:

-duke i dedikuar një hapësirë specifike aktiviteteve dhe raporteve tona në faqen zyrtare të Konferencës Ndërkombëtare dhe indeksimin e nismave tona kryesore të cilat na dhanë mundësi për të komunikuar brenda dhe jashtë komunitetit tonë të Autoriteteve të Mbrojtjes së të Dhënave,

-duke publikuar rregullisht aktivitetet e grupit tonë të punës në buletin e progresit të shteteve të ICDPPC,

-dhe për sa i përket inovacionit, duke lançuar **Çmimet e Para Globale të Privatësisë dhe Mbrojtjes së të Dhënave në vitin 2017**, të cilat prezantuan 46 iniciativa krijuese nga autoritetet tona në fushën e edukimit të privatësisë për publikun, të rinjtë dhe komunitetin arsimor.

Në vitin 2017, GPED ka arritur numrin e 54 anëtarëve nga autoritetet e privatësisë (AMDP), duke përfaqësuar 6 zona të mëdha të botës:

Evropa: 31

Afrika: 8

Azia-Paqësori: 6

Amerika e Veriut: 4

Amerika Latine: 4

Lindje e Mesme: 1

Ne mirëpresim autoritetet e tjera të cilët do të donin t'i bashkoheshin punës tonë.

Ky raport kërkon të analizojë tre veprimet kryesore të **programit të planit të veprimit** të grupit të punës për vitet **2016-2017** dhe të paraqesë një plan të ri për vitin e ardhshëm për t'u miratuar nga kolegët tanë të AMDP, në përputhje me objektivat që lidhen me rezolutat e Varshavës dhe Marakeshit në Edukimin Digjital.

Këtë vit, program-plani i veprimit u bazua kryesisht mbi zbatimin e *Rezolutës së Marakeshit për miratimin e një "Kudrit aftësimi ndërkombëtar mbi edukimin e privatësisë"* (tetor 2016). Kjo do të thotë, se dy prioritete fokusohen si një vazhdim i veprimeve të mbuluara nga aktivitetet e edukimit digjital, duke përfshirë ofrimin e resurseve të reja në "Kudrin e aftësimin" dhe një prioritet i tretë, që sugjerohet për t'u marrë me platformat *e-Learning* dhe shërbimet edukuese në internet.

1. Zbatimi i "Kudrit të aftësimin" në programet studimore dhe kurrikula, duke përfshirë organizimin e saj nëpërmjet përdorimit të burimeve mësimore të disponueshme në përputhje me grup-moshat në fjalë dhe propozimin e zgjidhjeve për trajnimin e mësuesve;
2. Evoluimi i shërbimeve dhe përmbajtja e platformës CIRCABC me shpërndarjen e burimeve edukuese digjitale në lidhje me mbrojtjen e të dhënave personale dhe vënia në dispozicion e bazës së burimeve edukuese për komunitetin arsimor;
3. Çështja e zhvillimit dhe përdorimi i gjerë mbi pjesën e komunitetit arsimor të platformave *e-Learning*, shërbimeve *online* dhe aplikacioneve dedikuara komunitetit arsimor në lidhje me çështjet e privatësisë.

Aksion 1: Zbatimi i "Kudrit të aftësimin mbi edukimin e privatësisë" në programet studimore dhe kurrikula, duke përfshirë zgjerimin e tij me burime mësimdhënie në përputhje me grup-moshat në fjalë dhe propozimi i zgjidhjeve për trajnimin e mësuesve.

Objektivi: **Garantimi i koordinimit dhe raportimit të duhur mbi progresin në lidhje me zbatimin e këtij "Kudri" në nivel kombëtar/rajonal nga autoritetet e mbrojtjes së të dhënave.**

Informacion *feedback* lidhur me këtë veprimtari tregon një mobilizim të fortë të dhënë nga një numër i madh autoritetesh (27) dhe në veçanti, mundësia për krijimin e partneriteteve me aktorët e arsimit në nivel vendor për të përfshirë "Kudrin e aftësimin" me burime të përshtatshme në kurrikulën e shkollës 9-vjeçare dhe trajnimin e mësuesve.

- Mbulimi mediatik i "Kudrit të aftësimin", dialogu me autoritetet përkatëse arsimore dhe integrimi në kurrikul

"Kudri i aftësimin" është promovuar gjerësisht në faqet zyrtare dhe rrjetet sociale të autoriteteve të mbrojtjes së të dhënave, gjithashtu edhe nëpërmjet aktiviteteve të organizuara nëpër shkolla dhe gjatë Ditës së Internetit të Sigurt (shkurt 2017). Shumë shtete kanë kontaktuar ministritë e tyre përkatëse - të Arsimit, Inovacionit Strategjisë Digjitale, apo edhe parlamentin e tyre, për ta integruar plotësisht këtë kuadër nëpër kurrikula.

Për këtë qëllim, ai është përkthyer në gjashtë gjuhë më shumë, konkretisht, në gjuhën **shqipe**, katalanase, hungareze, italiane, polake dhe spanjolle (përveçse, në origjinal në frëngjisht dhe anglisht).

Bashkëpunimi dhe partneriteti me autoritetet arsimore është forcuar dhe rezulton në projekte reformuese, që përfshijnë temën e edukimit digjital, zhvillimin e një auditi dhe listimi i të gjitha veprimtarive ekzistuese mbi mbrojtjen e të dhënave në klasa dhe kurrikula, duke krijuar grupe pune me ministrinë respektive, për të zhvilluar “Kwadrin” dhe plotësimin e tij me kapacitet dhe burime të nevojshme (njerëzore dhe financiare), inkuadruar në çdo cikël akademik apo krijimin e mjeteve në internet për të mundësuar lundrimin nëpërmjet kompetencave të “Kwadrit”.

- Feedback nga shkolla dhe partnerë të tjerë të fushës, promovimi i përdorimit të kwadrit në praktikat mësimore, adaptimi i burimeve nga kwadri aftësimi dhe grup moshat

Feedback-u ishte, veçanërisht, pozitiv nga shkollat mbi përdorimin e kwadrit të aftësimi përse i përket seminareve trajnuese të organizuara me studentët/nxënësit dhe prindërit e tyre. Një rishikim i burimeve në dispozicion në shkolla është kryer në mënyrë që të identifikohet ndonjë mangësi midis planeve mësimore ekzistuese dhe “Kwadrit të aftësimi” dhe përgatitja e materialeve të përshtatshme trajnuese për t’i adresuar ato.

- Zhvillimi i trajnimit fillestar dhe të vazhdueshëm për mësuesit/mbikëqyrja

Nëse “Kwadri” konsiderohet si një bazë e dobishme për të strukturuar qasjet e mësuesve, shumë vende po marrin parasysh programe më të zhvilluara për të rritur ndërgjegjësimin midis drejtorëve të shkollave dhe prindërve (*p.sh. video të reja për përthithjen e aftësive digjitale janë zhvilluar për një plan familjar trajnimi*). Module trajnimi janë zhvilluar për mësuesit dhe drejtorët e shkollave mbi parimet thelbësore të mbrojtjes së të dhënave, që synojnë arsimin profesional kombëtar, kontakte të tjera të dobishme janë kryer me universitete - për të zhvilluar trajnimin për mësuesit dhe me Institutet Kombëtar të Trajnimit të Arsimit, në disa vende. Të tjera programe trajnuese në internet po përgatiten aktualisht për t’ju ardhur në ndihmë mësuesve, stafit mbikëqyrës dhe drejtuesve të shkollës.

- Nismat e shtyra

Disa autoritete të tjera të mbrojtjes së të dhënave na informuan se nuk kanë plane në këtë fazë lidhur me këtë çështje, por do të mendojnë mundësinë e prioritizimit në të ardhmen, ndërkohë që vijojnë të zhvillojnë më tej programin e tyre aktual vjetor për ndërgjegjësimin në partneritet me shkollat.

Përsa i përket veprimeve pasuese për periudhën 2017-2018, (si një tjetër sfidë madhore që ka të bëjë me këtë rezultat), sugjerojmë që:

→ Autoritetet e mbrojtjes së të dhënave të vijojnë shkëmbimin e eksperiencave për të krijuar iniciativa të suksesshme dhe të përsëritura, për të integruar nëpër kurrikulat e shkollës mësimin e një kulture për mbrojtjen e privatësisë dhe të dhënave personale nëpërmjet “Kwadrit” dhe inputeve të tjera kryesore, të cilat janë thelbësore për përhapjen e kulturës digjitale tek qytetarët.

- **Diskutimi** nëse do të ishte e domosdoshme marrja parasysh për miratimin e një “Kudri” me version më të zgjeruar, renditur sipas grup-moshave përkatëse, të plotësuar me shembuj të burimeve të përshtatura, aty ku është e mundur, dhe me kushtin se progresi i avancuar i punës e lejon atë?
- Autoritetet e mbrojtjes së të dhënave ofrojnë asistencë për mësimin në klasë, nga njëra anë dhe mënyra trajnimi në fushën e edukimit digjital në përfitim të mësuesve dhe stafit edukativ, nga ana tjetër (në formën e *e-Learning* apo ndonjë metodë tjetër mësimi).

Aksioni 2: Plotësimi i platformës së internetit CIRCABC me shërbime të reja lidhur me shpërndarjen e përmbajtjeve për edukimin digjital për privatësinë dhe vënia në dispozicion të bazës së burimeve edukuese për komunitetin arsimor.

Objektivi 1: Nxitja e shpërndarjes së burimeve midis autoriteteve të mbrojtjes së të dhënave, e cila mundësohet nga përdorimi i platformës CIRCABC.

34 përdorues janë të regjistruar me statusin e kontribuuesit në platformën CIRCABC (në total janë regjistruar 26 autoritete të mbrojtjes së të dhënave).

Përditësimi i Librarisë në internet (të dhënat kryesore):

- 50 burime shtesë janë ngarkuar në vitin 2017 duke inkuadruar një përmbledhje të përmbajtjes së saj nga CNIL (në frëngjisht dhe anglisht);
- Një seksion i shtuar i dedikuar për “Guidën e prindërve”;
- Në fakt, shumë pak autoritete të mbrojtjes së të dhënave kanë ngarkuar burime të reja gjatë vitit, aksesit i regjistruar në faqe është gjithashtu i paqëndrueshëm (*disa kanë 400 klikime – kjo mund të variojë nga 5 deri 118 shikime në muaj që korrespondon me maksimumin e aktiviteteve të CNIL në ngarkimin e materialeve në platformë, në korrik 2017*);
- Publikimi në internet i një plani të detajuar në faqe, që synon të lehtësojë lundrim të thjeshtë dhe klasifikim në arkitekturën aktuale të platformës;
- Dërgimi i njoftimit tek anëtarët e regjistruar në CIRCABC mbi materialet e reja të ngarkuara është testuar tashmë. Kjo do t’i bënte anëtarët e grupit të interesuar më të vetëdijshëm për përmbajtjen e re në platformë dhe të rrisë interesin në dokumentet e ngarkuara (*funksionim i jashtëzakonshëm operacional që ofron mundësinë që anëtarët e tij të pranojnë apo refuzojnë ndonjë njoftim të mëtejshëm*).

Shifrat kryesore: 240 dokumente të ngarkuara në gjuhë të ndryshme, ndër të cilat:

- Burime të ndryshme të mësimdhënies dhe kualifikimit që ofrojnë *pajisje të përziara të gatshme për përdorim për mësuesit dhe studentët (me material trajnues në internet, kuize, artikuj, dokumente pune, ushtrime, lojëra, etj., udhëzues dhe ide për raste praktike për detyrat në klasë, video, posterat, materialet komike, faktet tematike, udhëzues për studentët/mësuesit; raporti studimor i vitit 2017 mbi burimet kryesore për autoritetet e mbrojtjes së të dhënave, kudri i aftësimi, udhëzuesit e prindëro*;
- Potenciali për më shumë se një 100 burime cilësore të identifikuara për ngarkim të mëtejshëm, i cili mund të përfshijë seri tematike edukuese nga grup-mosha në fjalë (nga burimi i faqeve të internetit të autoriteteve të mbrojtjes së të dhënave personale, Konferenca Ndërkombëtare ka listuar inventarin për Çmimet, faqe interneti institucionale kombëtare dhe ndërkombëtare);

- Por, ka patur shumë pak të dhëna mbi pjesën e autoriteteve të privatësisë.

Objektivi 2: Eksploroni mundësinë dhe fizibilitetin për të vënë në dispozicion të komunitetit arsimor bazën e burimeve edukative.

Kjo nismë mund të prekë të gjithë ose një pjesë të bazës së burimeve edukative që të shkarkohet nga faqja e aksesueshme publike për komunitetin arsimor në Evropë dhe më gjerë. Kjo mund të përfshijë, për shembull, një faqe interneti ndërkombëtare të specializuar për mbrojtjen e të dhënave dhe/ose portalet e internetit që ofrojnë tashmë burime edukuese.

Si informacion i parë feedback-u, portali publik "Open Education Europa" (OEE) www.openeducationeuropa.eu ofron akses në Open Education Repositories (OER – Depozitat e Edukimit të Hapur) pa patur nevojën e të drejtës së autorit në Evropë dhe më gjerë. Komuniteti përfshin rreth 20 mijë profesionistë të interesuar në *e-Learning*.

Komisioni Kombëtar për Liritë dhe Informimin (CNIL) ka testuar dhe ngarkuar kuadrin e aftësisë në platformën OEE, e cila është mirë-vendosur aktualisht në kreun e faqes midis shkarkimeve të lajmeve të fundit. Rezulton se një seksion specifik i dedikuar temave të mbrojtjes së të dhënave dhe privatësisë mund të hapet në janar të 2018 nga administratorët e platformës, nëse planifikojmë ta plotësojmë atë me më shumë informacion.

Kjo platformë është e hapur për të gjitha vendet evropiane dhe jo-evropiane.

Do të jetë një çështje për t'u diskutuar vlera e burimeve të lira pa të drejtë autori dhe bërja tërheqëse e kësaj platforme (OEE) për mësuesit dhe për të rishikuar ngarkesën e punës për të arritur këtë qëllim.

Me synimin për të prioritzuar plan-programin për periudhën 2017-2018 dhe për të lehtësuar shkëmbimin e informacionit në mënyrë që të zbatohet "Kuadri i aftësisë", sugjerojmë:

→ Autoritetet e mbrojtjes së të dhënave personale të ngarkojnë çdo material të vlefshëm pedagogjik që katë bëjë me fushën në platformën CIRCABC. Plotësimi me burime dhe me përmbajtje më specifike për mësuesit, për të mbështetur trajnimin e tyre profesional, për secilën fushë të njohurive dhe aftësive të mbuluara nga korniza e "Kuadrit".

→ Krijimin e një grupi të vogël drejtues për të vendosur një thirrje për shprehje interesi, me synimin që të kryejë me CNIL dhe CNPD (Autoritetin e Luksemburgut) një studim të zgjeruar për portale alternative arsimore.

Aksion 3: Çështja e zhvillimit dhe përhapja e përdorimit mbi pjesën e komunitetit arsimor të platformave *e-Learning*, shërbimeve *online* dhe aplikacioneve të dedikuara të komunitetit arsimor në lidhje me çështjet e privatësisë.

Shumë nga platformat *e-Learning* dhe shërbimet edukuese lehtësojnë komunikimin dhe mësimin bashkëpunues, por duke vepruar kështu, mbledhin, gjithashtu, sasi të mëdha të të dhënave *sensitive* për studentët, përfshirë sjelljet, qëndrimet dhe të dhënat personale të studentëve. Por a po mbrohen në mënyrën e duhur informacionet personale të studentëve?

Një pyetësor i detajuar u shpërnda në 15 korrik 2017 tek të gjithë Autoritetet e akredituar në emër të autoritetit kanadez (OPC), që vepronte si drejtuesi aktual në këtë aksion me angazhimin e autoritetit francez (CNIL).

Studimi synonte të shqyrtonte “çështjen e zhvillimit dhe përdorimin e përhapur tek mësuesit dhe studentët/nxënësit e tyre të platformave *e-Learning*, aplikacioneve dhe shërbimeve *online* dedikuar komunitetit arsimor, zhvillimin dhe vënien në dispozicion *online*, zakonisht pa pagesë nga ofrues shërbimi privat dhe ngritjen (si edhe në sektorë të tjerë) të çështjeve në lidhje me mbledhjen e të dhënave personale të studentëve, në veçanti, të të miturve.”

Vazhdimësia e aksionit të 2016-ës: Publikimi i një udhëzuesi për konkurset me të rinjtë mbi mbrojtjen e të dhënave.

Grupi i Punës për Edukimin Digjital (DEWG) sapo ka publikuar **një udhëzues metodologjik për të organizuar konkurse rinore mbi mbrojtjen e të dhënave.**

Rreth këtij udhëzuesi

Ky udhëzues është projektuar si një listë e plotë që identifikon pikat kryesore për t’u kujtuar kur lançohet ose zhvillohet një kompeticion/konkurs. Aty përshkruhen me detaje pyetje për t’i bërë vetes për çdo fazë të konkursit, *si çështjet buxhetore dhe komunikuese, kërkimi për partner të medias, kriteri i vlerësimit të aplikimeve për jurinë, ceremonia e shpërndarjes së çmimeve, vlerësimet vjetore të kompeticionit, si edhe strategjitë e menaxhimit të riskut.* Më pas udhëzuesi jep disa këshilla praktike në lidhje me të gjithë këto aspekte.

Udhëzuesi u hartua nga **Autoriteti francez i Mbrojtjes së të Dhënave (CNIL) dhe Zyra për Mbrojtjen e të Dhënave Personale të Çekisë** dhe me asistencën e vlefshme të autoriteteve të mbrojtjes së të dhënave, të cilët kanë zhvilluar tashmë konkurse kombëtare për të rinjtë (Studimi “Menaxhimi i konkurseve për të rinjtë për mbrojtjen e të dhënave personale - The management of competitions for young people on protection of personal data” – shtator 2015). Udhëzuesi është publikuar (fund-shtatori 2017) në faqen e internetit të Konferencës Ndërkombëtare në emër të këtij grupi pune (DEWG) dhe do të jetë i aksesueshëm si burim pa të drejtë autori.

Kush duhet ta përdorë këtë udhëzues?

Udhëzuesi synon të asistojë autoritetet e mbrojtjes së të dhënave që dëshirojnë të zhvillojnë konkurse për të rinjtë. Kjo është një sfidë shumë e këndshme për të promovuar brenda kuadrit të një kompeticioni, skenarë shumë inovativ dhe kreativ nga dhe për të rinjtë, duke synuar të ofrohen praktika të mira për të mbrojtur privatësinë në internet. Në tre vitet e fundit, CNIL po zhvillon në bashkëpunim me aktorët e Komunitetit të Edukimit Digjital dhënien e çmimeve “Educnum Trophies” dhe shoqërimi i mëtejshëm i të rinjve të moshës 18 dhe 25 vjeç në zhvillimin e projekteve inovative, duke përkrahur frymën e ekipit, për të krijuar mesazhe për rritjen e ndërgjegjësimit në një mënyrë të gjallë për të rinjtë!

*Ky është një përkthim jo zyrtar i Zyrës së Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, tetor 2017